Pyetje dhe përgjigje në çështjet e Imanit dhe Kufrit

Nga Hoxha i nderuar:

Salih ibn Fevzan ibn Abdullah Fevzan

1432 h

! !! ! !!!! ! ! !!!! !!! ! !

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të Dërguarin salAllahu alejhi ve selem mbi familjen e tij mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në ditën e Kijametit.

Këto pyetje të rëndësishme ua paraqesim nxënësve të diturisë dhe thirrësve për në rrugën e Allahut nga Hoxha i nderuar Shejh Salih ibn Fevzan ibn Abdullah Fevzan Allahu e ruajt dhe ia shtoftë diturin dhe i bëftë dobi kjo dituri Islamit dhe muslimanëve. U paraqesim juve duke e lutur Allahun që të na bën dobi neve dhe juve dhe të gjithë muslimanëve.

Pyetja e parë: Si bëhet kufri i madh apo riddeja? A është vetëm me besim, mohim dhe përgënjeshtrim apo është më e gjerë se kjo?

Përgjigjja: Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të

botëve paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të Dërguarin salAllahu alejhi ve selem, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në ditën e Kijametit.

Meselet e Akides janë shumë të rëndësishme dhe obligohet mësimi i akides në të gjitha detajet e saja dhe të gjitha meselet duke i marr nga dijetarët e Ehli-Sunetit. Është obligim për atë që dëshiron që ti bën dobi vetës së tij dhe ti bën dobi vëllezërve të tij muslimanë që ta mëson akiden prej pikës së parë deri tek ajo e fundit ta mëson atë nga dijetarët, nga librat e Ehli-Sunetit dhe selefëve. Me këtë zhduket injoranca dhe nuk vihet deri tek dyshimet dhe personi i tillë ka mundësi që t`ua shpjegon njerëzve të cilët janë të paditur në këto mesele sepse ky bëhet meritues në mësimin e meseleve të akides.

Gjithashtu mësimi i akides nuk merret vetëm nga librat, apo nga leximi dhe shfletimi, mirëpo akideja merret nga dijetarët të cilët flasin me argumente të cilët i kanë kuptuar meselet e akides nga Kurani dhe Sunneti, kjo është këshillë.

Kufri dhe rideja (dalja nga feja) bëhet kur kryhet ndonjë vepër e cila e asgjëson Islamin, ai i cili e vepron ndonjë

vepër e cila e prish Islamin ai me këtë vepër bëhet renegat (murted) dhe bëhet kafir, ne gjykojmë në atë që e shohim tek personi i tillë sepse ne gjykojmë në bazë të asaj që e shohim kurse zemrat nuk i din askush përveç Allahut të Lartësuar. Ai që ka folur fjalë të kufrit apo ka vepruar ndonjë vepër të kufrit gjykimi jonë mbi atë person për shkak të fjalës së tij dhe për shkak të veprës së tij i themi ke bërë ridde (ke dalë nga Islami dhe je bërë kafir).

Pyetja e dytë: Disa thonë: Imani është fjalë, bindje dhe vepër, mirëpo vepra është kusht plotësues në Iman, gjithashtu thonë: Nuk ka kufër përveçse me besim (bindje). Kjo fjalë a është nga fjalët e Ehli Sunetit apo jo?

Përgjigjja: Ai që e thotë këtë nuk e ka kuptuar Imanin dhe as nuk e ka kuptuar akiden kjo është ajo çfarë thamë në pyetjen para kësaj: Se është obligim që akideja të mësohet tek dijetarët dhe të merret nga burimet e sakta dhe do ta kupton përgjigjën e kësaj pyetje.

Fjala e pyetësit: Imani është fjalë, vepër dhe bindje, pastaj fjala e tij: Vepra është kusht plotësues në iman, kjo është gabim dhe në kundërshtim me besimin e ehli sunetit!! Si ka mundësi të thotë vepra është nga imani

pastaj të thotë vepra është kusht plotësues. Vepra në iman është kusht përbërës që nuk bën imani përveçse me të.

Pra imani është fjalë, vepër dhe bindje dhe vepra është nga imani dhe është iman dhe nuk është kusht plotësues por kusht përbërës në iman. Imani është fjalë me gjuhë, bindje me zemër, veprim me gjymtyrë dhe shtohet me adhurime dhe pakësohet me mëkate.

Pyetja e tretë: A janë veprat shtyllë në iman dhe pjesë përbërëse e tij apo janë kusht plotësues?

Përgjigjja: Kjo është e përafërt me pyetjen para sajë, pyetësi i kësaj pyetje nuk e din të vërtetën e imanit dhe për këtë ai është i dyshimtë dhe e përsërit: A janë veprat pjesë e imanit apo janë kusht i tij? Sepse ky nuk e ka marr akiden nga burimet dhe bazat dhe nga dijetarët. Kemi thënë se s`ka vepër pa iman dhe s`ka iman pa vepër këto janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, veprat janë nga imani dhe janë iman: Veprat janë iman, fjalët janë iman, bindja është iman dhe të gjitha këto bëjnë besimin në Allahun Fuqiplotë, besimin në librat, Pejgamberët, ditën e Fundit dhe besimin në kadan dhe kaderin të mirën dhe të keqen e tij.

Pyetja e katërt: Cilat janë llojet e Murxhiave? Duke i përmendur fjalët e tyre në meselet e Imanit?

Përgjigjja: Murxhiat janë katër grupe:

Grupi i parë: Janë ata të cilët thonë Imani është vetëm njohje edhe nëse nuk beson. Kjo është fjala e Xhehmijëve dhe është nga fjalët më të këqija dhe kjo është kufër në Allahun Fuqiplotë sepse idhujtarët e hershëm, Faraoni, Hamani, Haruni dhe iblisi secili nga këta e ka njohur Allahun Fuqiplotë dhe e kanë besuar Allahun me zemrat e tyre mirëpo pasi që nuk e kanë shqiptuar me gjuhët e tyre dhe s`kanë vepruar me gjymtyrët e tyre nuk u ka bërë dobi atyre vetëm njohja.

Grupi i dytë: Kanë thënë Imani është vetëm besim me zemër dhe kjo është fjalë e Esharive dhe s`ka dyshim se kjo gjithashtu është nga fjalët e kota sepse pabesimtarët besojnë me zemrat e tyre dhe e din se Kurani është i vërtetë dhe se i Dërguari alejhi selam është i vërtetë dhe jehudit dhe të krishterët e dinë këtë: Atyre që ua kemi dhënë librin, ata e njohin atë (Muhammedin) siç i njohin bijtë e vet, e një grup pre tyre edhe pse e dinë këtë, janë duke e fshehur të vërtetën. (Bekare, 147) ata besojnë në të Dërguarin me zemrat e tyre!

Thotë Allahu i Madhëruar për idhujtarët: Ne dimë se ty të brengos ajo që thonë, e ata nuk të gënjejnë ty, por ata mizorë mohojnë argumentet e All-llahut. (En`am, 33)....këta nuk e kanë shqiptuar me gjuhët e tyre dhe nuk kanë vepruar me gjymtyrët e tyre megjithëse këta besonin me zemrat e tyre dhe kjo nuk i bëri që të hyjnë në rangun e besimtarëve.

Grupi i tretë: Është ai grup i cili është përballë Esharive dhe këta janë Kerramit të cilët thonë: Imani është shqiptim me gjuhë edhe nëse nuk beson me zemër, s´ka dyshim se kjo është fjalë e kotë sepse dyfytyrëshat të cilët janë në shkallën më të ulët të zjarrit thonë: Dëshmojmë se s´ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Allahut këtë e thonë me gjuhët e tyre, mirëpo nuk besojnë dhe nuk binden me zemrat e tyre sikur thotë Allahu i Madhëruar: Kur të erdhën ty hipokritët, të thanë: “Ne dëshmojmë se vërtet ti je i dërguar i All-llahut!” E, All-llahu e di se ti je i dërguar i Tij, por All-llahu dëshmon se hipokritët janë rrenacakë (kur thonë ashtu). Ata betimin e tyre e bëjnë për t’u mbrojtur, andaj ata penguan nga rruga e All-llahut. Veprimi që bënë ata është shumë i keq. (Munafikun, 1-2) Dhe thotë Allahu i Lartësuar: Flisnin me gojët e tyre atë që nuk e kishin në zemrat e tyre, po All-llahu e di mirë për atë që fshehin. (Ali Imran, 167)

Grupi i katërt: Këta janë grupi më i lehtë në Irxha, këta thonë Imani është bindje me zemër dhe shqiptim me gjuhë kurse veprat nuk hynë në Iman dhe kjo fjalë është e Murxhiave Fukaha s`ka dyshim se edhe kjo fjalë është fjalë batil (e kotë).

Pyetja e pestë: A është mospajtimi i Ehli sunetit me murxhiat fukaha në veprat e zemrës apo të gjymtyrëve? Dhe a është mospajtimi në shprehje apo në aspektin kuptimor? Shpresojmë nga ju sqarim hoxhë i nderuar.

Përgjigjja: Mospajtimi i tyre është në vepër, mospajtimi i murxhiave fukaha me Ehli Sunetin është mospajtim në veprat e jashtme siq janë: Namazi, agjërimi, haxhi, murxhiat thonë veprat nuk janë nga imani mirëpo janë pjesë plotësuese dhe siq e kemi cek kjo është fjalë e kotë.

Dhe mospajtimi i murxhiave fukaha me ehli sunetin është në aspektin kuptimor jo në shprehje sepse ata thonë se Imani nuk shtohet dhe nuk pakësohet me vepra, thonë nuk shtohet me adhurime dhe nuk pakësohet me mëkate dhe thonë imani i njerëzve është i njëjtë tek të gjithë s`ka dyshim se kjo është fjalë batil (e kotë).

Pyetja e gashtë: Cili është vendimi i sheriatit ndaj atyre që i lanë të gjitha veprat e jashtme tërësisht mirëpo i shqipton dy shahadetet dhe i pranon obligimet mirëpo nuk vepron aspak nga këto, ky a është musliman apo jo? Duke e ditur se ky person s`ka arsye sheratike e cila e pengon nga kryerja e këtyre obligimeve?

Përgjigjja: Ky njeri nuk është besimtarë, kush beson dhe e pranon me zemrën e tij mirëpo nuk vepron me gjymtyrët e tij veprat e tij i asgjësohen të gjitha dhe nuk arsyetohet, ky nuk konsiderohet besimtarë sepse imani siq kemi thënë dhe siq e njeh Ehli Sunneti dhe Xhemati është: Fjalë me gjuhë, besim me zemër dhe veprim me gjymtyrë dhe nuk konsiderohet imani i vërtetë nëse nuk janë këto të tria bashkë dhe ai i cili e len njërën nga këto nuk quhet besimtarë.

Pyetja e shtatë: A është e saktë kjo shprehje: Kush thotë Imani është fjalë, vepër, bindje shtohet dhe pakësohet është distancuar nga Irxhaja tërësisht edhe nëse thotë s`ka kufër përveçse me bindje dhe mohim?

Përgjigjja: Kjo është në kundërshtim!! Nëse thotë s`ka kufër përveçse me bindje ose mohim kjo e kundërshton rregullën e ehli sunetit se Imani është fjalë me gjuhë, bindje me zemër dhe veprim me gjymtyrë kjo është në

kundërshtim nga aspekti i jashtëm sepse pasi që imani është fjalë e gjuhës, besim me zemër dhe veprim me gjymtyrë dhe ai shtohet me adhurime dhe pakësohet me mëkate, kjo jep të kuptosh se kush kundërshton diçka nga kjo ai nuk është besimtarë.

Pyetja e tetë: A është kjo fjalë e vërtetë apo jo: Se ai që e shanë Allahun apo të Dërguarin e Tij alejhi salatu ve selam nuk bën kufër në vetën e tij mirëpo është shenjë e mospërfilljes së fesë?

Përgjigjja: Kjo fjalë është batil (e kotë) sepse Allahu ka gjykuar mbi munafikat me kufër pas imanit (besimit) vetëm pse kishin thënë: S`kemi parë sikurse këta shokët e Muhammedit bark mëdhenj dhe frikacakë në takimin me armikun – e kishin për qëllim Muhammedin dhe sahanët - Allahu për këta e zbriti fjalën e tij: E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: "Ne vetëm jemi mahnitur e dëfruar". Thuaj: "A me All-llahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?" Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi që (shpallët se) besuat, keni mohuar. Nëse një grupi nga ju i falim, grupin tjetër e dënojmë, ngase ishin kriminelë. (Teube, 65-66) Allahu i quajti kafira vetëm pse e thanë këtë fjalë dhe nuk e bëri kush në kufrin e tyre se ata kanë qenë që kanë besuar me zemrat e tyre por i

quajti kafira vetëm pse e thanë këtë fjalë, gjithashtu fjala e Allahut: Ata betohen në All-llahun se nuk kanë thënë (asgjë të keqe), e në të vërtetë kanë thënë fjalë që nuk përkojnë me besimin, dhe pasi patën shprehur besimin ata e mohuan... (Teube, 74) Allahu e numëroi kufër atë që u tha me fjalë (nga kjo kuptojmë se kufri bëhet me fjalë).

Pyetja e nëntë: Cili është vendimi i sheriatit për atë i cili e ofendon Allahun, të Dërguarin apo e shanë fenë e Allahut, kur këshillohet për këtë arsyetohet duke thënë se këtë e bëj vetëm për të fituar ushqim dhe rriskë, ky a është kafir apo muslimanan që ka nevojë me u edukuar ?

Përgjigjja: Nuk lejohet që njeriu të bën kufër në Allahun as me fjalë as me vepër as me besim (bindje) dhe të thotë kjo është për shkak të fitimit të pasurisë, rrisku është tek Allahu i Lartësuar Allahu Fuqiplotë thotë: E kush u përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë, dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare. (Talak, 2-3) Rrisku është në dorën e Allahut Fuqiplotë, Allahu e ka quajtur kafir atë që i jep përparësi jetës së kësaj bote para botës tjetër, thotë Allahu i Lartësuar kur i përshkruan renegatët dhe hipokritët: Këtë (dënim të madh) ngase ata më tepër e deshtën jetën e kësaj bote

se sa jetën e botës tjetër, e All-llahu nuk udhëzon njerëzit jobesimtarë. (Nahl, 108) Gjykoi për ta me kufër vetëm pse ata e braktisën imanin vetëm për shkak se ata dëshironin që të jetonin me njerëzit dhe të jenë me njerëzit: E sikur të kënaqeshin me atë që ua dha All-llahu dhe i dërguari i Tij, e të thonin: “Neve na mjafton All-llahu, All-llahu do të na furnizojë nga të mirat e Tij, e edhe i dërguari i Tij, dhe se vetëm te All-llahu e mbështesim dëshirën (do të ishte shumë më mirë për ta)”. (Teube, 59) Sikur të ishin mbështetur në Allahun Allahu Fuqiplotë do ti furnizonte ata .

Pyetja e dhjetë: Cili është vendimi për ata që i kanë ngritur idhujt (statujat) tyrbet, varrezat dhe kanë ndërtuar xhami mbi varreza dhe kanë lënë vakf pasuri dhe tokë për këto dhe ua kanë mundësuar njerëzve që të bëjnë adhurime, tavaffe rreth këtyre dhe ata iu luten dhe therin për këto vende?

Përgjigjja: Gjykimi i Islamit ndaj këtyre personave është se këta janë kafira me këtë vepër sepse vepra e tillë është kufër dhe thirrje në kufër në Allahun e Lartësuar.

Ndërtimi i tyrbeve thirrja e njerëzve në adhurimin e varreve që gjinden në to kjo tregon se ata kënaqen me

këto dhe jep të argumenton se këta thirrin në kufër dhe devijim Allahu na ruajt.

Pyetja e njëmbëdhjetë: A njihet namazi pas imamit i cili kërkon ndihmë nga të vdekurit apo jo?

Përgjigjja: Nuk pranohet namazi mbrapa atij i cili bën shirk të madh që e nxjerr nga feja, lutja dhe kërkimi nga të vdekurit është shirk i madh që të nxjerr nga feja Islame.

Ky person nuk është musliman nuk lejohet të falet namazi pas tij, obligohet që imami të jetë besimtarë në Allahun dhe Pejgmaberët e Tij dhe të punon me Islam me anën e jashtme dhe të brendshme.

Kurse nëse një njeri i vepron disa mëkate prej mëkateve të mëdha: Si p.sh: Gënjen dhe bën mëkate që nuk janë shirk si p.sh. i shqetëson muslimanët. Këto janë mëkate prej mëkateve të mëdha nuk janë kufër dhe nuk është e rrugës që këta të vendosen Imam mirëpo kush shkon për tu falur dhe e gjen atë imam duke u falur falet pas tij dhe nuk bën të vazhdoj të falet (pas tij) vetëm se derisa ta gjen një imam të mirë të sinqertë dhe të shkon tek ai për tu falur.

Pyetja e dymbëdhjetë: Janë disa hadithe me të cilat argumentohen disa se ai që i len të gjitha veprat në tërësi ai është besimtarë me iman të mangët si p.sh hadithi (S`kanë vepruar asnjë të mirë), pastaj hadithi i Bitakes (kartelës) dhe hadithet e tjera. Si është përgjigja ndaj këtyre?

Përgjigjja: Ky argumentim i tillë është për shkak të dyshimeve dhe kjo metodë është e atyre që kanë devijuar dhe iu janë sëmur zemrat e tyre dhe për të tillët Allahu ka thënë: E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti. (Ali Imran, 7) Këta i marrin argumentet e dyshimta dhe i lan argumentet e qarta, patjetër duhet që gjërat e pa qarta të kthehen në ajetet e qarta, i Dërguari salAllahu alejhi ve selem ka thënë: Kush thotë La ialahe il-lAllah dhe e mohon atë që adhurohet përveç Allahut ndalohet derdhja e gjakut të tij dhe marrja e pasurisë së tij ...dhe ka thënë: Allahu ia ka ndalur zjarrit të xhehenemit ta djeg atë që thotë La ilahe il-lAllah dhe me të kërkon fytyrën e Allahut. Ky

person s`ka pas mundësi të vepron por vetëm e ka shqiptuar shahadetin, është bindur në kuptimin e kësaj fjale dhe ka qenë i sinqertë me Allahun Fuqiplotë mirëpo para tij s´ka mbetur asnjë rast që të vepron dhe ka vdekur dhe ky person është ai i cili hynë në xhennet (p.sh.: Ky ka mundësi qe e ka pranuar Islamin dhe ka vdekur ose menjëherë ose në luftë) dhe ky person hynë në xhennet vetëm me shahadet dhe në këtë kuptim bartet edhe hadithi i bitakas (kartelës), po kështu ata të cilët dalin nga zjarri dhe s`kanë vepruar asnjë të mirë janë ata që s`kanë pas mundësi të veprojnë asgjë nga veprat megjithëse e kanë shqiptuar shahadetin dhe kanë hyrë në Islam, ky është bashkimi i haditheve.

Pyetja e trembëdhjetë: Cili është vendimi për atë i cili i lutet dikujt tjetër përveç Allahut kurse ai jeton në mesin e muslimanëve dhe i ka arritur Kurani, a konsiderohet ky musliman apo është mushrik (politeistë)?

Përgjigjja: Kujt i arrin Kurani dhe Sunneti në atë mënyrë që mund ta kupton sado pak nëse dëshiron pastaj nuk punon me të dhe nuk e pranon atë këtij personi iu është ngritur argumenti dhe nuk arsyetohet me xhehel

(injorancë) sepse i ka arritur argumenti, Allahu i Lartëmadhëruar thotë: E mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush deri në ditën e kijametit). (En`am, 19) Pa marr parasysh a jeton në mesin e muslimanëve apo jeton me jo muslimanët. Prandaj secilit të cilit i arrin Kurani dhe ai mundet me kuptua nëse donë pastaj nuk punon me të nuk bëhet besimtarë dhe nuk arsyetohet me injorancë.

Pyetja e katërmbëdhjetë: A është kusht në ngritjen e argumentit t`ia kumtosh argumentin me një kuptim të qartë dhe të shëndosh apo mjafton vetëm ngritja e argumentit? Ju lutem një sqarim për këtë duke sjellë argument?

Përgjigjja: Këtë e thamë në përgjigjen para sajë, se kur ti arrin argumenti nga Kurani dhe Suneti në atë mënyrë që e kupton nëse dëshiron dhe në mënyrën që ai e kupton pastaj nuk kthehet nga argumenti dhe nuk vepron me këtë ky nuk arsyetohet me injorancë sepse ky është mospërfillës.

Pyetja e pesëmbëdhjetë: A ka bërë tekfir shejhul Islam ibn Tejmije Allahu e mëshiroftë në ata që nuk e japin zekatin kur e ka bërë këtë me ata që kanë bërë ride kanë dalë nga feja prej arabëve për shkak të mohimit të tyre të obligueshmëris së zekatit apo për shkak të mosdhënies dhe mos kryerja e këtij obligimi?

Përgjigjja: Këtë e kanë sqaruar dijetarët dhe kanë thënë: Mos-dhënësi i zekatit nëse e mohon obligueshmërin e tij bën kufër dhe mbytet si renegat (murted), mirëpo nëse nuk e jep zekatin për shkak të koprracisë kurse ai beson në obligueshmërin e tij luftohet derisa ti nënshtrohet dhënies së zekatit dhe nuk gjykohet ky person me kufër, mirëpo luftohet për shkak të ndalimit të zekatit derisa ti merret pjesa që duhet dhënë. Sa i përket asaj që i mvishet shejhul Islam ibn Tejmijes se ai e ka bërë tekfir atë që e mohon dhe atë që nuk e jep nga koprracia unë nuk kam lexuar për një gjë të tillë.

Pyetja e gjashtëmbëdhjetë: Cili është vendimi për heqjen e sheriatit Islam dhe zëvendësimi i tij me nenet dhe ligjet si p.sh Kanunin francez, britanez e të tjerë, mirëpo në mesin e këtij kanuni është sheriati Islam për dispozitat e nikahut (kurorëzimit) dhe trashëgimisë?

Përgjigjja: Kush e heq sheriatin Islam duke e ndaluar dhe në vend të tij vendos një kanun kjo jep sinjal se ai person e lejon këtë gjë, sepse ai nuk e tërheq dhe zëvendëson dhe nuk ia ndërron vendin e tij me ndonjë kanun tjetër përveçse e shef se ai është më i mirë se sheriati Islam bën kufër dhe del nga feja e Allahut.

Kurse sa i përket asaj se të gjykuarit me sheriat në meselet e niqahut dhe trashëgimisë ky beson në një pjesë të librit dhe e mohon pjesën tjetër d.m.th. në disa çështje gjykon me sheriat kurse në disa të tjera ndalet, feja nuk pjesë-zohet gjykimi me sheriat nuk ndahet dhe nuk pjesë-zohet, patjetër duhet që të vendoset dhe të pasohet gjykimi me sheriat me një pasim të plotë dhe jo të gjykohet me një pjesë dhe të braktiset pjesa tjetër.

Pyetja e shtatëmbëdhjetë: Cili është vendimi për ata që thonë: Se lënësi i veprës së gjymtyrëve tërësisht bën kufër?

Përgjigjja: Kjo është ajo që e përmendëm më lartë se vepra është prej Imanit dhe vepra është iman, ai që e len bëhet lënës i imanit (besimit) pa marr parasysh a e len

veprën në tërësi apo len diçka prej veprës dhe e shef se ajo vepër nuk është nga Imani dhe nuk e shef hyrëse në Iman. Ky person hynë në grupin e murxhiëve.

Pyetja e tetëmbëdhjetë: Tekfiri i selefëve që ia kanë bërë grupit Xhehmi a i kanë bërë kufër të madh që i kanë nxjerr nga feja apo kufër të vogël ?

Përgjigjja: Tekfiri që e kanë bërë selefët mbi xhehmitë është kufër i madh sepse ata (xhehimit) e kanë mohuar fjalën e Allahut Fuqiplotë, kanë thënë: Fjala e Allahut është e krijuar dhe i kanë mohuar emrat dhe vetitë (cilësitë) e Allahut duke ia prishur kuptimin, ata e përgënjeshtrojnë atë që gjendet në Kuran dhe Sunet prej emrave dhe cilësive të Allahut dhe gjithashtu besojnë se Allahu është në çdo vend i Lartë qoftë Allahu nga ajo që ia përshkruajnë dhe ia mveshin pabesimtarët. Fjalët e tyre janë kufër i madh dhe tekfiri që e kanë bërë selefët për xhehmit është kufër i madh përveç atyre që i ndjekin ata duke menduar se ata janë në hakk dhe nuk e njohin medh`hebin e tyre dhe nuk e njohin të vërtetën e fjalëve të tyre ky arsyetohet me xhehl (injorancë).

Pyetja e nëntëmbëdhjetë: Çfarë kuptimi ka fjala e shejhul Islam Muhammed ibn Abdul Uehabit Allahu e mëshiroftë në veprën e tretë prej veprave të cilat e asgjësojnë Islamin tërësisht: Kush nuk i bën kafira mushrikët (idhujtarët) apo dyshon në kufrin e tyre apo ua vërteton medh`hebin e tyre ai është prej tyre (pabesimtarëve)?

Përgjigjja: Po, ai është ashtu (pabesimtarë) sepse ai është i kënaqur në atë në të cilën gjinden ata dhe është në pajtueshmëri në atë në të cilën janë ata, kush nuk i bën tekfirë (nuk iu thotë kafira), apo kënaqet me atë në të cilën gjinden ata, apo ua përkrah dhe i mbron ata ai është sikurse ata (pabesimtarë), sepse ai është kënaqur me kufër dhe e ka pranuar dhe nuk e ka kundërshtuar.

Pyetja e njëzet: Cili është vendimi i sheriatit për personin i cili thotë: Nëse një person nuk i bën tekfir të krishterët për shkak të mos arritjes së ajetit të sures Maide: Gjithashtu bënë kufër (mosbesim) ata që thanë: "All-llahu është i treti i treve". S'ka në gjithësi tjetër pos një All-llahu, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë (tre zotëra), do t'i kapë dënim i dhembshëm ata që nuk

besuan prej tyre. (Maide, 73) Ai nuk bën kufër derisa t`jua bën të njohur ajetin?

Përgjigjja: Nuk është tekfiri i krishterëve dhe jehudive i përcaktuar vetëm në suren Maide, mirëpo Allahu i ka bërë ata kafira në shumë vende të Kuranit, gjithashtu kufri i tyre është i qartë dhe i dukshëm në fjalët dhe veprat e tyre dhe në librat të cilat ata i mësojnë, si p.sh. fjala e tyre: Mesihu (Isai) është birë i Allahut apo fjala e tyre Allahu është i treti i treve apo fjala e tyre Allahu është Isai i biri i Merjemës apo fjala e jehudive Uzejri është birë i Allahut apo fjala e tyre Allahu është i varfër kurse ne jemi të pasur apo fjala e tyre dora e Allahut është e shtrënguar dhe të ngjashme si këto gjinden në librat e tyre që i kanë në duart e tyre. Pra kufri i tyre është i qartë dhe i dukshëm gati në të gjitha suret e Kuranit jashtë sures Maide.

Pyetja e njëzet e një: Cili është argumenti për ligjësimin e kushteve të fjalës La ilahe il-lAllah, siq janë: Dituria, nënshtrimi, besnikëria, sinqeriteti, dashuria, pranimi dhe bindja dhe cili është vendimi i sheriatit për atë person i cili thotë: Mjafton vetëm ta shqiptosh fjalën La ilahe il-lAllah me fjalë pa i plotësuar këto kushte?

Përgjigjja: Ky person që e thotë këtë fjalë ose është i devijuar dhe dëshiron ti devijon edhe të tjerët ose është xhahil (injorant) dhe nuk i kupton meselet sidomos fjalën la ilahe il-lAllah.

Fjala la ilahe il-lAllah nuk është vetëm shqiptim por patjetër duhet të kuptohet dhe të punohet çfarë kërkon kjo fjalë, nuk është vetëm fjalë që thuhet me gjuhë dhe kaq, argument për këtë është hadithi i të Dërguarit salAllahu alejhi ve selem: Kush thotë La ilahe il-Allah dhe e mohon atë që adhurohet përveç Allahut ka për të hyrë në xhenet. Apo fjala e të Dërguarit salAllahu alejhi ve selem: Allahu ia ka ndaluar zjarrit ta djeg atë që thotë: La ilahe il-Allah dhe me këtë e kërkon fytyrën e Allahut. Gjithashtu hadithi i të Dërguarit salAllahu alejhi ve selem: Jam urdhëruar që ti luftoj njerëzit derisa të thonë La ilahe il-Allah dhe kur ta thonë atë i kanë të mbrojtura nga unë gjakun e tyre, pasurin e tyre përveç me të drejtë të Islamit. Përveç me të drejtën e fjalës: La ilahe il-Allah, nuk mjafton vetëm shqiptimi i fjalës La ilahe il-Allah nëse nuk e veprojnë atë që kërkohet nga kjo fjalë e ajo që kërkohet nga kjo fjalë është vepra dhe puna me atë që përmban kjo fjalë dhe kuptimi i kësaj fjale. Pra fjala La ilahe il-Allah nuk është vetëm shprehje që

shqiptohet me gjuhë dhe prej këtyre haditheve i kanë marr dijetarët kushtet e fjalës La ilahe il-Allah.

Pyetja e njëzet e dytë: Ju lutem na e tregoni komentin e fjalës së Allahut të Madhëruar: Ai që pas besimit të tij e mohon All-llahun, me përjashtim të atij që dhunohet (për të mohuar), e zemra e tij është e bindur plotësisht me besim.... (Nahl, 106) Dëshirojmë koment të qartë duke e përmendur dhe vendimin e sheriatit mbi personin e detyruar (me dhunë) në këtë ajet?

Përgjigjja: Ky ajet argumenton se ai i cili flet dhe i shqipton fjalët e kufrit duke qenë i imponuar (nen dhunë) në të dhe duke mos u bindur dhe besuar në atë që e shqipton, mirëpo e thotë këtë për të shpëtuar me të nga dhunimi dhe personi i tillë është i arsyetuar.

Sikur transmetohet në ngjarjen e Ammar ibn Jassirit radijallahu anhu pasi që idhujtarët e kishin imponuar atë që ta ofendonte të Dërguarin salAllahu alejhi ve selem, e rrahën atë dhe refuzuan që ta lëshojnë derisa ta ofendon të Dërguarin salAllahu alejhi ve selem, Ammari radijallahu anhu foli me gjuhën e tij atë që ata e kërkuan prej tij kurse ata e liruan, pastaj erdhi te i Dërguari salAllahu alejhi ve selem dhe e pyeti për këtë? I Dërguari

salALlahu aljehi ve selem i tha: Si e ndien zemrën tënde? Tha zemrën time e gjej me besim në Allahun dhe të Dërguarin, Allahu e zbriti: Ai që pas besimit të tij e mohon All-llahun, me përjashtim të atij që dhunohet (për të mohuar), e zemra e tij është e bindur plotësisht me besim, por fjala është për atë që ia hap gjoksin mosbesimit, ata i ka kapur hidhërimi nga All-llahu dhe ata kanë një dënim të madh. (Nahl, 106) Nëse njeriu e thotë fjalën e kufrit dhe me këtë dëshiron të shpëton nga rreziku i madh që i kanoset dhe i imponohet një gjë e tillë kurse zemra e tij është e mbushur me iman atëherë lejohet për të detyruarin që me dhunë ta thotë fjalën e kufrit duke mos besuar dhe duke mos qenë i kënaqur me zemrën e tij, po kështu fjala e Allahut: Përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. All-llahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm tek All-llahu është e ardhmja. (Ali Imran, 28) D.m.th. nga pabesimtarët kjo sa i përket kur njeriu imponohet kurse në rastet tjera nuk lejohet pajtueshmëria dhe as dhënia e asaj që kërkojnë ata prej fjalëve të kufrit dhe veprave të kufrit.

Pyetja e njëzet e tretë: Cili është vendimi i sheriatit për ata që i miqësojnë pabesimtarët dhe mushrikët? Kur

konsiderohet kjo miqësi ndaj tyre kufër i madh që të nxjerr nga feja? Dhe kur është mëkat i madh prej mëkateve të mëdha?

Përgjigjja: Allahu i Lartëmadhëruar thotë: O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. (Amaide, 51) Gjithashtu fjala e Allahut: O ju që keni besuar, mos u miqësoni me një popull që All-llahu ka shprehur hidhërim kundër tij, popull që ka humbur shpresën ndaj botës së ardhshme, ashtu si nuk kanë shpresë jobesimtarët prej të vdekurve (që do të ngjallen) në këtë botë, ose në ringjallje (në botën tjetër). (Mumtehine, 13)

Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerë në xhennete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty janë, përgjithmonë. All-llahu ua ka pëlqyer punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me

shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e All-llahut, ta dini pra, se ithtarët e All-llahut janë ata të shpëtuarit. (Muxhdele, 22)

Obligohet armiqësia e pabesimtarëve dhe urrejtja e tyre dhe mos ndihmesa e tyre kundër muslimanëve, duhet të ndërpriten marrëdhëniet me ta nga ana e dashurisë dhe respektit dhe duhet të urrehen për shkak të kufrit që e kanë, të gjitha këto kërkohen nga muslimani që ti ndërpres dhe të largohet nga ata dhe mos ti donë dhe mos t`ju ndihmon atyre kundra muslimanëve mos ti mbron ata dhe mos t`ua përkrah fenë e tyre por të flet haptas për devijimin e fes së tyre dhe kufrin e tyre dhe t`ua tërheq vërejtjen muslimanëve nga një gjë e tillë.

Pyetja e njëzet e katërt: Cila është këshilla juaj për nxënësit e diturisë, për ata të cilët dëshirojnë mësimin e meseleve të Teuhidit, shirkut dhe meselet e Imanit dhe kufrit? Cilat janë librat të cilat flasin për këto mesele?

Përgjigjja: Këto për të cilat pyet pyetësi i gjen në përgjigjet e lartshënuara sepse ajo që është thënë këtu është marr nga librat e selefëve të mirë, obligohet që të kthehet kërkuesi në librat e selefëve dhe fjalët e sahabëve, tabiinëve dhe atyre që i pasuan me të mirë të

cilët ishin nga gjeneratat e dalluara këto mesele i gjen në librat e tyre me lejen e Allahut, pastaj ti shfletosh librat e Teuhidit, akides dhe Imanit që i kanë shkruar dijetarët e mëdhenj të Ehli Sunetit Allahu i mëshiroftë.

Prej këtyre dijetarëve janë Shejhul Islam ibn Tejmije Allahu e mëshiroftë, librat e Imam ibn Kajjimit Allahu e mëshiroftë, librat e shejh Muhammed ibn Abdul Vehabit Allahu e mëshiroftë, librin e Tahaviut Akidetu Tahavijje.

Këto janë nga librat e Ehli Sunetit dhe nga akideja e vërtetë prandaj le te kthehet muslimani në to.

Akideja është ajo që më së shumti kemi nevojë dhe sikur i gjithë ky ummet ta përmirësonte akiden dhe ti bashkëngjitej grupit të ehli sunetit dhe xhematit do ti vinte fitorja këtij ummeti brenda një nate.

Më së shumti duhet ti kushtohet kujdes dhe rëndësi akides pa akide veprat nuk pranohen dhe mos rregullimi i akides është shkak për asgjësimin e veprave.

Vetëm nga Allahu është suksesi. Shpëtimi dhe përshëndetja e Allahut qoftë mbi të Dërguarin tonë Muhammedin salAllahu alejhi ve selem mbi familjen dhe shokët e tij.

Përgatiti: -Ebu Merjem-